



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 636, datë 10.10.2024

P Ë R

DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.443,
DATË 26.6.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE,
“PËR ORGANIZIMIN E PROCESIT MËSIMOR DHE PËRZGJEDHJEN
E ARSIMTARËVE NË DIASPORË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 10, të ligjit nr.16/2018, “Për diasporën”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe të ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

I. Në vendimin nr.443, datë 26.6.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin e procesit mësimor dhe përzgjedhjen e arsimtarëve në diasporë”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Fjalja e dytë, e pikës 2, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Ky proces realizohet në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për punët e jashtme dhe diasporën, sipas fushës së saj të përgjegjësive shtetërore.”.

2. Pas pikës 2 shtohen pikat 2/1, 2/2, 2/3, 2/4 dhe 2/5, me këtë përmbajtje:

“2/1.Në rastet kur ministria përgjegjëse për punët e jashtme dhe diasporën propozon organizimin e procesit mësimor në një vend, me të cilin nuk ka marrëveshje dypalëshe ndërkombëtare, planifikimi dhe zbatimi i kurrikulës, zhvillimi profesional i arsimtarëve, pajisja me tekste mësimore dhe materiale ndihmëse për mësimin e gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë bëhet nga ministria përgjegjëse për arsimin. Përzgjedhja e arsimtarëve realizohet bashkërisht nga ministria përgjegjëse për punët e jashtme dhe diasporën dhe ministria përgjegjëse për arsimin, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2/2.Për rastet e parashikuara në pikën 2/1, lidhja e kontratës individuale me arsimtarin në diasporë kryhet nga kreu i misionit diplomatik të akredituar në vendin ku ndodhet diaspora.

2/3.Pagesa e arsimtarëve në diasporë përlllogaritet bazuar në numrin e orëve mësimore mujore, të përcaktuara në kontratën e lidhur ndërmjet palëve, referuar pagesës së personelit vendas të misioneve diplomatike të Republikës së Shqipërisë në vendin ku ndodhet diaspora.

2/4.Procesi mësimdhënës organizohet e realizohet nëpërmjet shoqatave kulturore, lidhjeve të mësuesve apo të shkollave shqipe, të regjistruara si organizata jofitimprurëse, në përputhje me legjislacionin e vendit ku veprojnë.

2/5.Procedura e përzgjedhjes së arsimtarëve të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë, autorizimi dhe lidhja e kontratës individuale me arsimtarin, si dhe monitorimi i mësimdhënies përcaktohen në udhëzimin e përbashkët ndërmjet ministrit përgjegjës për arsimin dhe ministrit përgjegjës për punët e jashtme dhe diasporën.”.

3. Pika 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“6. Ministria përgjegjëse për punët e jashtme dhe diasporën dhe ministria përgjegjëse për arsimin, nëpërmjet Qendrës së Botimeve të Diasporës, mbështesin dhe inkurajojnë procesin mësimor të mësimin të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë me tekste shkollore, me materiale plotësuese dhe me zhvillim profesional të arsimtarëve.”.

4. Pikat 7, 9 dhe 11 shfuqizohen.

NR.PROT.5488/1
DATË 14.10.2024

MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT
MINISTRISË PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGAÇI



Engjëll Agaçi